

11. Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatët blerës në kopje fizike, me postë ose dorazi, në vendi e përcaktuar në dokumentet e ankandit.

BASHKIA MIRDITË **NJOFTIM ANKANDI**

1. Autoriteti shitës: Bashkia Mirditë, Adresa “sheshi Abat Doçi”

2. Data e zhvillimit të ankandit 06.07.2020 ora 10.00

3. Lloji i Procedurës standarde të ankandit
Ankandi do të zhvillohet me procedurë të hapur.

Objekti i Shitjes: “Dhënie me qira të pasurisë së paluajtshme sipas udhëzimit nr.1 datë 09.06.2016” Për Rregullat, Procedurat e Kërkimit, të Shqyrtimit e të Miratimit të Kërkesave për Dhënie në Përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosur Publik”: që i përket ekonomisë pyjore: Kunorë – Valmor, me ngastrat nr.93c, 94c, 94d, 94e, 95d, 94a, 94b, në sipërfaqe prej 5.28644 ha ,me vlerë fillestare 366 157.6 leke,” Për mbarrëshkrimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme” me afat përdorimi (qiraje), 10 (dhjetë) vite në numrat e pasurisë nr.402, zk.2327, vol.1, faqe 203 me certifikatë pronësie nr.1009652, me veprimtari: Për qëllime pushimi, argëtimi

4. Përshkrim i shkurtër i objektit të shitjes;

Dhënie me qira të fondit pyjor me sipërfaqe prej 5.28644 ha në pronësi të Bashkisë Mirditë, për Për qëllime pushimi, argëtimi të detajuar në tabelën e më poshtme:

Ekonomi a pyjore	Ngastra	Përdorimi i territorit	Sip. ha	Sipërfaqja me Qira ha	Tarifa dhënie në përdorim lek/ha/vit	TOTALI lekë
					6 deri 10 vjet	
1	2	3	4	5	6	7
Kumbull Kunore- Valmor	Nr.93c,94c, 94d,94e,95d ,94a,94b		5.28644 ha	5.28644 ha		
TOTAL						

5. Vlera fillestare është 366 157 lekë sipas raportit teknik (treqinde gjashtedhjetee gjashtëmije e njëqinde pesëdhjetee shtate).

6. Vendi i zhvillimit të ankandit: (Adresa):
Bashkia Mirditë, zyra juridike ,Sheshi “Abat Doçi” Rrëshen.

7. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje:
06.07.2020 ora 10.00, ofertat duhet të jenë të hartuara në gjuhën shqipe.

8. Informacion mbi dokumentet e ankandit:

Dokumentet e ankandit mund të trerhiqen prane autoritetit shites

Dokumente me pagesë:

	Po	X	Jo	☐
Nëse Po	Monedha	Lek	Çmimi	2000

9. Dokumentet standarde të ankandit përbehen nga:

- Formulari i njoftimit;
- Kërkesa për pjesëmarrje;
- Formulari i ofertës;
- Ftesa për oferte;
- Formulari i njoftimit të fituesit;
- Formulari i publikimit të njoftimit të fituesit;
- Procesverbali/et i/e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Kërkesat për kualifikim dhe vërtetimet e kërkuara

Në përputhje me LAP, Kandidatet blerës duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme për tu kualifikuar:

- a. formularin e sigurimit të ofertës për shumën dhe vlefshmërinë e kërkuar në dokumentet standarde të ankandit;
- b. kërkesë së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e tyre adresën e subjektit, telefon, email dhe faks;
- c. ekstraktin e regjistrimit në QKB për objektin e veprimtarisë;
- d. certifikatën e regjistrimit në organin tatimor ose NIPT-in.
- e. ne rastin e personave fizik dokumenti origjinal i identifikimit një kopje e te cilit depozitohet pranë komisionit të ankandit
- f. të dhëna për kapacitet teknike, stafin, makineritë dhe pajisjet që zotëron
- g. lejen mjedisore për aktivitetin e kërkuar;
- h. garanci financiare të mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes;
- i. të ketë të kontraktuar një specialist të fushës, ku në CV-në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë, në lidhje me objektin e ankandit;
- j. vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, hetim në proces, detyrime tatimore ose detyrime ndaj Bashkisë Mirditë.

Kriteret që do të vlerësohen dhe sistemi i pikezimit;

Vlerësimi i ofertës mbështetet në grumbullimin e pikëve si më poshtë:

- a) projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet, i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10000 ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: kufijtë natyrorë, relievi,

objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit 20 pikë;

b) planbiznesi dhe investimet që do të bëhen 15 pikë;

c) planin e rehabilitimit të sipërfaqes 25 pikë;

d) nivelin e punësimit në veprimtari 5 pikë;

e) masën e qirasë për ha/vit 35 pikë

Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet blerës ne kopje fizike, me postë ose dorazi, në vendin e përcaktuar në dokumentet e ankandit.